



REPUBLIKA E SHQIPERISE

RAPORT TEKNIK

Studim - Projektim "Korce - Erseke Loti 2" (Vazhdimi)



1. HYRJE

1.1. Parathenie

Projekti i Zbatimit "Rruga Korce - Erseke "(Loti 2) eshte rezultati i bashkepunimit me pergjegjesit lokale dhe komunitetin e zones ku u finalizuan kontrolltet dhe verifikimet e domosdoshme; si dhe pervesetimi i te dhenave gjeologjike dhe gjeoteknike , topografike etj.

Ky aks i ri rrugor do te ndertohet si zgjatim i Lotit 1 te rruges Korce- Erseke per arsye se ky lot aktualisht shfrytezohet me ane te rruges provizore e cila lidh segmentin e vjeter me segmentin e ri . Lidhja e rruges se re me aksin e vjeter rrugor eshte kryer ne afersi te majes se Qarrit dhe nga kjo pike deri tek ura e Dukës rruga kalon ne nje zone teper malore me pjerrresi deri ne 10 % (me konkretisht 9.93%) ne te cilen ne Kthesen e Vreshtit ka edhe prezence te shkarjes se tokes. Per arsyet e sipershenuara u zgjodh nje variant i ri dhe i pershtatshem teknikisht qe i jep zgjidhje perfundimtare problematikes ne fjale. Keshtu varianti i zgjedhur do te kete pike nisje fundin e aksit te ri te Lotit 1 te rruges Korce-Erseke i ndertuar vitet e fundit dhe do te pershkoje nje gjurme krejt te re deri ne unazen e qyteti te Ersekës. Projekti i propozuar perfshin ndertimin Lotit 2 te segmentit rrugor "KORCE - ERSEKE", ndertimin e disa veprave te artit per perforcimin dhe mbrojtjen e trupit te rruges , nje Box 6x(10x5) mbi perroin e Konopishtes dhe nje Ure te re mbi Perroin e Selenices.

Rruga qe do te ndertohet perfshin pjesen nga zona prane Qafes se Qarrit ne kufi me rrethin e Korces deri ne unazen e qyteti i Ersekës. Gjatesia totale arrin ne 17 km dhe eshte trajtuar ne dy pjese, Korce- Erseke Lot 2 pjesa e Pare me gjatesi L= 4+150 Km (Pk1 ÷ Pk 167) dhe Korce- Erseke Lot 2 Vazhdimi ,L =12+850 km (Pk 167 ÷ Pk 681) .

Ky aks rrugor pas kilometrit 5.0 kalon ne Pllajen e Kolonjes qe paraqet nje terren relativisht te sheshte dhe me pjerrresi te bute. Vlen per tu theksuar se pjesa e pare e ketij segmenti te ri rrugor qe do te ndertohet kalon kryesisht ne seksione te thella germimi te tipit usek, detyruar kjo nga kuota e lidhjes me aksin ekzistues te Lotit 1 te kesaj rruge gje qe ka sjelle domosdoshmerine e perdorimit te perforcimit te skarpatave anesore te rruges me mure prites dhe masa te tjera inxhinierike.

Gjatesia e pergjithshme "Korce - Erseke Loti 2" (Vazhdimi) sipas projektit te ri eshte 12.85 km , ndersa kurora e rruges eshte 6,5 m .

Ne pjesen e pare, traseja e rruges kalon prane dhe ben lidhjen e fshatrave Helmes, Pepellash, Roshanj, Boshanj, Qafezez dhe Mollas ndersa ne pjesen e dyte fshatrat Qinam, Vodice, Skorovot, Bejkove, Selenice, Starje dhe Psar duke perfunduar ne qytetin e Ersekës.

Rruga fillon Pk 167, ne kuoten 861.98m dhe perfundon ne Pk 681 ne kuoten 1012.50m. Pergjithesisht traseja e rruges eshte zgjidhur te kaloje ne nje geometri pa kthesa te shumta.

Gjatesia e rruges Korce-Erseke Loti 2 eshte L= 12+850 km duke perfshire rrugen automobilistike kryesore, tombinot bokse dhe uren 4x29. Projekti i rruges se re sic u permend edhe me siper nuk ka ruajtur gjurmen ekzistuese per shkak se terreni neper te cilin kalon kjo e fundit ben te pamundur kryerjen permiresimeve te nevojshme ne planimetri per kthesat dhe ne profilin gjatesor sidomos ne disa zona qe kerkojne nderhyrje per uljen e pjerresive dhe sistemimin e ujrave. Bazuar ne te dhenat ekonomiko sociale te zones, zhvillimet aktuale dhe te perspektives, eshte zgjedhur varinatti:

1.2 Vendodhja e objektit, gjendja ekzistuese, relievi, gjeologjia dhe hidrologjia

Ne kete projekt, trajtohet "Korce - Erseke Loti 2" (Vazhdimi) qe perfshin pjesen nga Pk 167 deri ne Pk 681, ne hyrje te qytetit te Ersekës.


E gjithë zona ku kalon rruga pershkohet nga nje numer i konsiderueshem proskash e perrenjsh nder te cilet me kryesoret jane perrenjte e Selenices, Qinamit, dhe te Konopishtit te cilat perbejne pjesen e siperme te rrjedhes se tyre, ndersa ne pjesen fundore ata derdhen ne lumin Osum qe rrjedh ne anen Perendimore dhe Veri-Lindore te rajonit.

Pergjithesisht traseja e rruges ekzistuese ne pjesen e pare kalon ne kushtet e nje terreni te pjerrret dhe malor, me kthesa te shpeshta dhe te ngushta te cilat veshtiresojne nje shfrytezim te mire dhe te pershtatshem te saj, kurse pjesa tjeter kalon pa kthesa te forta per vete kushtet e terrenit relativisht te sheshte. Ne keto kushte ne kuader te ketij projekti eshte parashikuar te evitohet traseja ekzistuese duke shmangur kthesat e shumta dhe permiresuar dhe pjerresite e medha te rruges ne fragmente te ndryshme te saj. Benefitet e ketij devijimi verehen vecanerisht aty ku rruga ekzistuese paraqitet me kthesa te shumta dhe me rreze te vogel.

Erseka është një qytet në Rrethin e Kolonjës me rreth 7.750 banorë. Qyteti ndodhet në juglindje të Shqipërisë në Pllajën e Kolonjës .

Është krijuar rreth vitit 1768 me rreth 100 shtëpi (sipas Edit Durham) banorë te ardhur nga fshatrat përreth dhe të vendosur buzë rrugës që lidhte Korçën me Leskovikun. Erseka shtrihet në pjesen juglindore të Shqipërisë, bën pjesë si njësi fiziko-gjeografike në krahinën malore qendrore, pjesa Jugore. Erseka është kryeqendra e rrethit të Kolonjës .

Në lindje të saj ndodhet mali i Gramozit me një lartësi prej 2523 mbi nivelin e detit. Në perëndim të saj ndodhet Mali i Radomit. Pragu i Qarrit e ndan këtë Gropë nga Fushgropa e Korçës. Dhe Jug të saj shtrihet Malësia e Gërmenjit .



m
në

Kjo Gropë përshkohet nga një sërë përenjsh të cilat përmblihen në pellgun ujëmbledhes të Osumit, kemi përroit e Starjes, Taçit dhe një sër të tjerë të vegjël me karaktere stinore të aktivitetit të tyre. Gropa e Kolonjës është njësi fiziko - gjeografike më e rëndësishme për këtë zonë. Në këtë zonë jeton pjesa më e madhe e popullsisë së këtij rrethi. Lumi i Osumit i kalon tërthor Gropës, në pjesën perëndimore të saj. Në këtë Gropë është vendosur dhe vendbanimi parahistorik i Ollmit të Qinamit i cili ndodhet në majën e një kodre në afërsi të fshatit Qinam si dhe shpella e Kamnikut. Mali Gramoz Shërben si kufi ndarës i kësaj zone nga territori i Greqisë. Rrëzë këtij mali janë vendosur një sërë fshatrash .

Korça

Pozita gjeografike: Qyteti i Korçës shtrihet në pjesën juglindore të Shqipërisë dhe është qendra e banuar më e madhe e pellgut me të njëjtin emër. Pellgu i Korçës ka një lartësi mesatare prej 850m mbi nivelin e detit, me gjërësi 16 km nga perëndimi në lindje dhe me gjatësi 35 km nga jugu në veri, dhe zë një sipërfaqe prej 300km². Korça ka një pozite të favorshme gjeografike pasi ndodhet në rrugët tregëtare që lidhin Shqipërinë me Maqedoninë (47km) dhe Greqinë (35km).

Qyteti i Korçës shtrihet në pjesën juglindore të Shqipërisë dhe është qendra e banuar më e madhe e pellgut me të njëjtin emër. Pellgu i Korçës ka një lartësi mesatare prej 850m mbi nivelin e detit, me gjërësi 16 km nga perëndimi në lindje dhe me gjatësi 35 km nga jugu në veri, dhe zë një sipërfaqe prej 300km². Korça ka një pozite të favorshme gjeografike pasi ndodhet në rrugët tregëtare që lidhin Shqipërinë me Maqedoninë (47km) dhe Greqinë (35km)

1.2.1 Klima

Rajoni i Korçës bën pjesë në zonën mesdhetare paramalore, e cila ka një klimë të karakterit kontinental, me dimër të ftohtë dhe me një rritje të theksuar të temperaturës gjatë verës. Muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare 0,4°C, ndërsa më i ngrohti është gushti me 20,6°C. Gjatë dimrit temperatura është më e ulët se 0°C.

Përgjithësisht Korça ka mot të thatë: lagështia relative mesatare vjetore është 68%. Muaji me më shumë rreshje është nëntori (rreth 104,9mm) pastaj dhjetori, tetori, janari e shkurti. Vera zakonisht është e thatë, gjatë të cilës bien rreth 14% e reshjeve vjetore. Ndër reshjet vjetore një pjesë bien në formë bore, të cilat janë të përvitshme. Gjatë periudhës dhjetor-janar arrihet numri më i madh i ditëve me dëborë. Korça (rrethi) shtrihet në pjesën Juglindore të Shqipërisë, në Krahinën Malore Qëndrore. Përfshin tre qytete: Korça, qendër e rrethit, Bilishti e Maliqi dhe 27 komuna.

Qyteti i Korçës është një nga qytetet kryesore të Shqipërisë, qendër rrethi. Shtrihet në pjesën Juglindore të vendit, në rrëzë të malit të Moravës, në lartësinë 869 metra mbi nivelin e detit. Relievi është kryesisht malor e kodrinor. Lartësia mesatare është 1145 metra. Korça, si rajon, është e rrethuar nga një numër i konsiderueshëm kodrash e malesh, në lindje

qyteti kufizohet me malin e Moravës dhe në perëndim me zonën e Gorës, Voskopojës dhe Vithkuqit, të cilat janë zonat më malore.

Në jug ndodhet Mali i Qarrit dhe në pjesën veriore është Mali i Thatë. Zona e ulët përfshin fushën e Korçës, një ndër më të mëdhatë e Shqipërisë dhe fusha e Devollit të sipërm. Zona e Korçës është e pasur me burime nënujore, lumenj, ku më i rëndësishmi është lumi i Devollit me degën Dunavec dhe Osumi i sipërm. Në këtë zonë gjenden burimet e tre lumenjve të Shqipërisë (Devoll, Shkumbin dhe Osum). Liqenet janë Prespa e Madhe dhe Prespa e Vogël. Korça kufizohet në veri me qytetin e Pogradecit i cili ndodhet 41 kilometra, në jug me qytetin e Ersekeës, 45 kilometra, në lindje me Bilishtin, 27 kilometra, dhe në perëndim me Skraparin. Qyteti i Korçës ndodhet 181 kilometra nga kryeqyteti i vendit, Tirana.

Korça karakterizohet nga një klimë pjesërisht mesdhetare malore dhe pjesërisht kontinentale, me dimër të ftohtë dhe verë të nxehtë e të thatë. Temperatura mesatare vjetore arrin deri në 10.6°C. Muaji më i ftohtë është janari dhe muaji më i nxehtë është gushti. Muaji më i lagësht është nëntori me reshje shiu mesatarisht 104 milimetra ndërsa sasia mesatare vjetore e reshjeve arrin në 720 milimetra. Karakterizohet nga disa erëra lokale si Voskopojarja, erë jug-perëndimore, Morava, Devollka etj.

Klima e gropës së Kolonjës është e freskët dhe kushtëzohet nga pozita gjeografike dhe sidomos nga lartësia e madhe mbi nivelin e detit (mbi 1000 m), ekspozimi i saj nga veriu (lartësia relative e pragut të Qarrit 200-300 m) e nga jugu (lartësia relative e pllajës së Shalësit 200 m) si dhe nga grykat e qafat e shumta në lindje dhe në të cilat fryjnë erëra, që ndikojnë në klimën e kësaj grope. Temperatura mesatare vjetore është 9.8°C, e janarit 0.6°C, e gushtit 18.6°C dhe amplituda e temperaturës vjetore 18°C. Kjo amplitudë është më e vogël se ajo e Korçës për arsye të hapjes më të madhe të saj dhe të ventilimit më të madh.

Kjo dukuri ndikon edhe në vlerat jo shumë të theksuara të maksimumeve dhe minimumeve absolute. Kështu, maksimumi absolut në këtë gropë është 34.9°C, ndërsa minimumi absolut – 19.5°C. Periudha vegjetative në të arrin në rreth 180 ditë. Ngricat janë një dukuri e zakonshme dhe zenë rreth 30 ditë në vit.

1.2.2. Popullsia

Qyteti i Korçës numëron rreth 86 176 banorë, me një ndarje pothuajse të njëjtë të femrave dhe meshkujve (sipas të dhënave statistikore të vitit 2007). Në një analizë të vitit 2004, vihet re që numri i popullsisë "hyrëse" në qytet është më i madh se ai i popullsisë "dalëse". Kjo tregon për një tendencë shtimi të qytetit, me gjithë rënien e menjëhershme që pësoi pas vitit 1990 prej migrimit brenda vendit dhe emigrimit jashtë shtetit të një numri të konsiderueshëm banorësh të qytetit, si dhe për shkak të studenteve, të cilët pas

perfundimit te studimeve kane pasur tendence te ushtrojne profesionin e tyre ne vendin apo qytetin ku kane ndjekur studimet e tyre.

Popullsia e qytetit te Ersekës shkon në rreth 10000 banorë sipas regjistrimit të nëntorit 2010 me një përbërje 50,8 % meshkuj dhe 49,2 % femra. Dendësia mesatare e qytetit është rreth 3200 banorë për km². Rreth 65 % e popullsisë i përkasin besimit mysliman, rreth 33% atij ortodoks dhe 2 % atij protestant. Emigrimi dhe ulja e nivelit të lindjeve janë ndër faktorët më kryesorë që popullsia në Ersekë në vitet pas hyrjes së demokracisë ka shkuar gjithnjë e në rënie.

1.2.3.Gjeologjia

Nga ana gjeologjike rajoni perben ekstremin Jug-Lindor te zones tektonike Krasta-Cukal ku takohen si formacione flishore apo molasike e karbonatike, ashtu dhe formacione magmatike .Ne kete menyre ne rajonin tone takohen si formacionet sedimentare ashtu dhe ato magmatike intrusive.Foracionet sedimentare i perkasin moshave Trias-Jure , Jure-Krede, Krede-Paleogen dhe Neogen-Kuaternar.

NDERTIMI GJEOLGJIK I RAJONIT

Nga ana gjeologjike rajoni perben ekstremin Jug-Lindor te zones tektonike Krasta-Cukal ku takohen si formacione flishore apo molasike e karbonatike, ashtu dhe formacione magmatike qe i perkasin zones tektonike te Mirdites.


Ne kete menyre ne rajonin tone takohen si formacionet sedimentare ashtu dhe ato magmatike intrusive. Foracionet sedimentare i perkasin moshave Trias-Jure , Jure-Krede, Krede-Paleogen dhe Neogen-Kuaternar. Formacionet e moshes Trias-Jure (T3-J1) takohen ne pjesen veriore te rajonit, mbi Uren e Floqit dhe perfaqesohen nga shkembij karbonatik me perberje gelqerorësh, gelqerore dolomitike dhe gelqerore silicore. Keto formacione nuk takohen ne pjesen ku kalon traseja e rruges.

Formacionet e Jure - Kredes (J3t-Cr1) perfaqesohen nga formacione flishoidale me perberje shtresash mergelore- alevrolitike- ranore dhe gravelite e konglomerate. Keto formacione takohen ne pjesen veriore te rajonit dhe perbejne zonen ku kalon nje pjese e trasese se rruges. Formacionet e Kredes (Cr2) kane perhapje te kufizuar ne rajon dhe takohen prane fshatit Skorovod dhe pjeserisht ndertojne kodren e Qinamit. Keto formacione perfaqesohen nga gelqerore dhe gelqerore dolomitike si dhe gelqerore pllakore. Traseja e rruges ne asnje pjese te saj nuk eshte e ndertuar mbi keto formacione.

Formacionet e Paleogenit (Pg1-2) perfaqesohen nga flishe me perberje shtresash argjiloro-alevrolitike dhe ranore te alternuara ndermjet tyre. Keto formacione nuk takohen gjate trasese se rruges, por prania e tyre konstatohet prane fshatit Shtike si dhe pjeserisht ne kodren e Qinamit.

Formacionet e moshes Neogen – Kuarternar (N2- Q1) ndertojne pjesen qendrore te rajonit duke filluar nga dalja e fshatit Qinam dhe vijojne ne drejtim Verior dhe Veri-Perendimor perkatesisht deri prane fshatit Helmes dhe Qafzez. Keto formacione perfaqesohen nga alternime shtresash konglomeratike me ranore dhe argjila dhe karakterizohen nga cimentimi i dobet deri ne shkrikerim te tyre nga nje shkalle e larte perajrimi. Pergjithesisht keto formacione mbulohen nga nje shtrese eluvialo-deluviale e perbere nga dhera suargjilore me permbajtje fraksionesh te trasha dhe copezore. Mbi keto formacione dhe depozitime kalon nje pjese e konsiderueshme e trasese se rruges.

Formacionet Magmatike perfaqesohen nga shkembijultrabazike, kryesisht serpentinite (G-J2-3) dhe takohen ne pjesen veriore te zones ku ndertojne masivin malor prane Qafes se Qarit. Ne keto formacione kalon pjesa e fillimit te trasese se rruges qe trajtohet ne kete projekt. Ne kete zone keto formacione paraqiten ne nje shkalle te larte perajrimi dhe ne mjaft raste te mbuluara me nje shtrese te kufizuar deluvionesh me permbajtje material copezore.



Vec formacioneve shkembore te pershkruara me siper nje perhapje te gjere ne rajon kane dhe depozitimet kuaternare (Q3-Q4) te cilet per faqesojne depozitimet me te reja nder to dhe ato qe depozitohen aktualisht vecanerisht ne shtretet e perrenjve qe perfaqesojne zonen.

Depozitimet kuaternare ne pjesen me te madhe te tyre ndertojne vete pllajen e Kolonjes, ku trashesia e tyre e kalon nga disa metra ne mbi 10-20m. ato perfaqesohen nga depozitime aluvialo-deluviale me perberje materialesh te trasha, zaje, popla, zhavorri dhe rera te vendosura ne trajte shtresash apo linzash, si dhe perzierje ndermjet tyre.

Keto depozitime pergjithesisht mbulohe nga nje shtrese suargjilore me ngjyre kafe dhe me permbajtje fraksionesh copezore si dhe zaje e gure me sasi te ndryshme shtrese e cila perfaqeson tokat bujqesore te kesaj

zone.

Vec sa me siper takohen depozitimet e sotme aluvialo- proluviale qe i perkasin shtreteve te perrenjve qe pershkojne zonen te cilat takohen brenda shtratit te ketyre perrenjve si dhe ne zonat perreth tyre. Keto depozitime perbehen nga zaje, popla dhe zhavorre me pak rere, me perberje kryesisht ranore-gelqerore dhe ultrabazike, ne gjendje pak deri mesatarisht te rumbullakosura, trashesia e te cilave kalon nga 3-6m dhe ne ndonje rast me teper.

Ne pjesen e pare te trasese, kemi te bejme me formacione flishoidale te moshes Jure-Kredi si dhe me formacionet ultrabazike. Keto formacione paraqiten mjaft te perajruar deri ne copezim apo dhe vecime te blloqeve te shkeputur me mbushje te carjeve dhe te materialit copezor me dhera suargjilore mbulesore.

Ne pjesen e dyte kemi te bejme kryesisht me depozitime te moshes se Kuaternalit(Q3-4) te cilat ne pjesen e sipërme te tyre ku do te ndertohet traseja, perfaqesohen nga shtresa suargjilore ngjyre kafe ne gjendje mesatarisht te ngjeshura dhe me permbajtje materiali zallore dhe zhuri ne sasi nga 15-25%.

Nga ana gjeologjike-inxhienerike, traseja ndodhet ne kushte te mira dhe pa problem te dukshme lidhur me qendrueshmerine e saj, nuk verehen fenomene gjeodinamike si rreshqitje etj.


Ne mjaft raste, traseja e re kalon ne germime te thella dhe me useke. Ne keto raste skarpatat e ketyre germimeve te thella do te behen te shkallezuara dhe me bankina te ndermjetme.

Ne rastet kur traseja kalon ne mbushje, ato do te behen me materiale te trashe (zhavore apo cakull) dhe te ngjishen me mjete te posacme si dhe sipas rastit do te shoqerohet me vepra arti si mure mbajtese, tombino etj.

1.2.4.HIDROLOGJIA

Konsiderata te pergjitheshme

Zona Korce - Erseke, sipas ndarjes klimatike te Shqiperise bën pjesë ne zonen klimatike mesdhetare paramalore nenzona jugore .



Horografia e zones qe pershon rruga

Për te plotësuar më mirë analizën klimatike te ketij pellgu, krahas te dhenave per stacionet e Ersekes dhe te Korces (me lartesi perkatesisht 1030m dhe 899metra mbi nivelein e detit), janë marrë në konsideratë edhe seritë klimatologjike të stacioneve te cilet bejne pjese ne pellgjet ujembeledhes te kesaj zone.

Rrezatimi diellor dhe diellzimi

Nga të dhënat rezulton se sasia vjetore e rrezatimit të përgjithshëm diellor arrin vlerën 1430 Kwh/m². Nga ecuria ndërvjetore e këtij elementi, shihet se vlera më e lartë e tij arrihet në korrik (225 Kwh/m²) dhe ajo më e ulët në dhjetor (65 Kwh/m²).

Kjo zonë, ashtu si edhe në rastin e rrezatimit diellor, karakterizohet nga një numër i madh i orëve me diell. Mesatarisht gjate vitit ka 2400 orë me diell, me vlerën më të lartë në korrik me 355 orë dhe atë më të ulët në Janar me 110 orë.

Regjimi i temperaturës së ajrit

Siç e përmendëm dhe më sipër, pozicioni gjeografik dhe format e ndrysheme te relievit reflektohen ndjeshëm në kushtet klimatike të zonës, dhe sidomos në vlerat e temperaturave të ajrit. Nje perfytyrim te pergjithshem te regjimit termik te nje zone jep shqyrtimi i vlerave mesatare vjetore te temperatures.

Konkretisht, temperaturat mesatare vjetore luhaten nga 6°C deri ne 10 °C. Keto jane vlera mesatare te nxjerra nga nje seri e gjate vrojtimesh (30, 40vjet) te pranuar nga Organizata Boterore e Meteorologjise.

Per te evidentuar ecurine brendavjetore te ajrit le t'i referohemi tab2.1.1 ne te cilen jepen vlerat mesatare te temperatures se ajrit per çdo muaj ne zonen Erseke - Korce.

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
°C	1	4	6	10	13	17	19	20	16	10	6	2

Temperatura mesatare mujore e ajrit

Siç shihet temperatura mesatare ka nje ecuri normale me nje maksimum ne muajt e veres dhe minimum ne muajt e dimrit. Shif fig.I.1.1 Keshtu muaji më i ftohte i vitit eshte Janari ku temperaturat mesatare eshte 1°C. Ndersa muaji me i ngrohte eshte muaji gusht me vlere te temperatures mesatare 20°C.




Fig.Ecuria brendavjetore e temperatures mesatare ajri

Ekstremet absolute në këtë zone janë relativisht të theksuara. Kështu vlerat minimale absolute të temperaturës së ajrit për të gjithë periudhën e regjistrimit janë -19.5°C (14 janar 1968) në Erseke. Ndërsa temperaturat maksimale absolute të vërtetuara kanë qenë 34.9°C (14 gusht 1957) në Erseke .

Reshjet atmosferike

Reshjet mesatare vjetore janë rreth 950 milimetra . Për periudhën e ngrrohte (Prill-Shtator) rreshjet mesatare të shiut janë rreth 300 milimetra dhe për periudhën e ftohte (Tetor-Mars) rreshjet mesatare të shiut janë rreth 650 milimetra.

Po të studiojmë shpërndarjen brendavjetore të reshjeve në këtë zonë vërejmë që kjo shpërndarje është e pabarabartë në periudha të ndryshme të vitit. Sasia më e madhe e reshjeve bie gjatë gjysmës së ftohtë të vitit rreth 70%, ndërkohë që gjatë muajve të verës sasia e tyre është më e vogël, rreth 30%.

Kjo shpërndarje lidhet me veprimtarinë e theksuar ciklonare gjatë muajve të ftohtë të vitit, e cila shoqërohet me mot me vranësira dhe reshje të bollshme.


Në tabelën e mëposhtme jepen sasitë për çdo muaj të reshjeve që bien në këtë zonë. Këto vlera janë rezultat i përpunimit të serive shumëvjeçare të reshjeve (30,40 vjet), seri vërtetuesh dhe pranuar nga Organizata Botërore e Meteorologjisë për kryerjen e studimeve klimatike të një rajoni të dhënë.

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Rreshjet	100	85	70	60	55	50	30	35	60	130	145	150

Sasia mujore shumëvjeçare e reshjeve


Ecuria brenda vjetore e reshjeve

Siç shihet nga te dhenat e tabelës me lart dhe nga paraqitja grafike , shpërndarja e reshjeve gjate




vitit ka formën e “U” që shpërh qartë regjimin mesdhetar të reshjeve.

Një tregues i rëndësishëm dhe i dobishëm për qëllime hidroteknike dhe urbanistike është sasia e reshjeve maksimale 24 orëshe dhe reshjet maksimale për intervale të tjera kohor për periudha të ndryshme përsëritje.



Shpërndarja e Reshjeve $t = 24 h$ ($p = 1\%$)



Shperndarja e Reshjeve $t= 24\text{ h}$ ($p=2\%$)

Bora

Renia e reshjeve atmosferike ne formen e bores eshte nje dukuri e zakonshme pothuajse e pervitshme. Rreshjet e debores kane nje kohezgjatje mesatare 20-25 dite ne vit. Mesatarja e trashesise maximale te shtreses se debores arin 23 - 27cm. Numri i diteve me shtrese debore ne kete zone eshte 33 - 36 dite ne vit.

2. PROJEKTIMI GJEOMETRIK I GJURMES


Theksojme faktin, qe rruga ne fjale eshte vazhdim i Rruges Korce -Erseke Lotit 1 dhe projekti eshte hartuar duke ruajtur lidhjen/ vazhdimesine me kete lot persa i perket zgjidhjes gjeometrike (planimetrike & altimetrike) / paketes se shtresave rrugore/ kategorise se rruges dhe te gjithe elementeve te tjere duke u shmangur keshtu nga kategorite e percaktuara ne Standardeve te projektimit te rrugeve.

Konkretisht ne manualin: "RREGULLI TEKNIK PËR NDËRTIMIN E RRUGËVE", vëllimi 1 (RTPRr-1), "Te pergjithshme dhe Pune Pergatitore", paragrafi 2.12 Shmangiet nga Standartet ne faqen 33c ku citohet:

Në disa raste, kërkesat teknike të një dokumenti kërkojnë përmbushjen e disa kritereve, të cilat në disa raste nuk mund të realizohen plotësisht në praktikë. Kjo mund të ndodhë, për shëmbull, për arsye të tilla si lidhja me një rrugë ekzistuese, ose pakësimi i ndikimit mbi një pronë ose mbi mjedisin, kur çështjet e sigurisë nuk janë plotësisht të zbatueshme dhe kostoja për plotësimin e të gjitha kërkesave është e pa justifikueshme.

Për rastet e rrethanave të veçanta dhe kur zbatimi i drejtpërdrejtë i standarteve nuk mund të justifikohet për një arsye të përcaktuar mirë, përdoruesit duhet të propozojnë shmangie nga kriteret (e vendosura) ose të propozojnë kritere plotësuese (për aspekte që nuk parashikohen nga dokumentat ekzistuese) që bazohen mbi një vlerësim të arsyeshëm.

Per sa me siper rruga Korce -Erseke Lotit 2- Vazhdimi eshte rruge nationale nderurbane me keto parametra:



- **Kurora e rruges**
 - a. 2 x 3.25m (korsi kalimi) + 2 x 1 (bankine)
 - b. Gjeresia e asfaltuar e kurores se rruges 6.5 m.
 - c. Gjeresia e kurores se rruges 8.5 m.

- **Paketa Asfaltike per Rrugen**

Shtresat e rruges se projektuar per autostraden :

- Shtrese Asfaltbetoni 5cm
- Binder 6cm
- Stabilizant 25cm
- Cakell makinerie 30cm
- d. Shpejtesia e projektuar ne km/ore ne terren kodrinor:
V p =60 km/ore
- e. Shpejtesia e projektuar ne km/ore ne terren malor:
V p =50 km/ore
- f. Pjerresia maksimale gjatesore 8.50 (%)
- g. Rrezet e projektimit te perdorura jane me te medha se 300m.
- h. Referuar nyjeve ku rruga do te kryqezohet me rruget ekzistuese jane projektuar ne te tille menyre qe te respektojne rrezet e pershkruara me siper ne standartet e projektimit dhe per te siguruar shikueshmerine ne kthese.

2.1.1 Planimetria

Ne hartimin e planimetrise jane marre parasysh;

- **Shpejtesia e projektimit**
 - 80 km/ore per terrene fushore
 - 60 km/ore per terrene kodrinore
 - 50 km/ore per terrene malore
 -

Klasifikimi terreneve eshte bere si me poshte;


- Terrene fushore klasifikimi; kur disniveli tokes nuk e kalon 30m/ per km
- Terrene kodrinore klasifikimi; kur disniveli tokes varjon 30m/ km deri 80m/km
- Terrene malor klasifikimi; kur disniveli tokes eshte me i madh se 100m/ km

- **Numri minimal i kthesave per 1km**
 Per shpejtesine 50km/ore - Numuri kthesave jo me shume se 5 /km
 Per shpejtesine 35km/ore - Numuri kthesave jo me shume se 7 /km
 Per shpejtesine 30km/ore - Numuri kthesave jo me shume se 8 /km
- **Rezet min. Ne kthesa ne funksion te shpejtesise;**
 Per shpejtesine 50km/ore - $R_{min} = 75m$
 Per shpejtesine 35km/ore - $R_{min} = 30m$
 Per shpejtesine 33km/ore - $R_{min} = 25m$

3.Projekti i Zbatimit

Aksi i Ruges fillon Pk 167, ne te cilin eshte parashikuar Box Box 6x(10x5) me gjatesi $L=23.5$ m mbi Lumin e Konopishtes dhe perfundon ne Unazen e qytetit te Ersekës. Ky Projekt Zbatimi e trajton Aksin Korce -Erseke Lot 2 - Vazhdimi si vazhdimesi te Aksit Korce-Erseke Lot 1 ne aspektin e parametrave gjeometrik dhe altimetrik, paketes se shtresave rrugore dhe sigurise rrugore. Rruga Korce -Erseke Lot 2 -Vazhdimi me gjatesi $L=12+850$ km eshte rruge nacionale dhe aksi eshte teresisht i ri duke permbushur me se miri kushtin e nje distance te konsiderueshme(300-400 m) me zonat e banuar duke bere qe:

- Shpejtesia e lejuar te arrije 60km/ore
- Duke qene se aksi kalon ne nje largesi te konsiderueshme nga zonat e banuara sinjalistika e nevojshme do te jete me e reduktuar.
- Rritet siguria rrugore dhe minimizohen rastet e aksidenteve te kembesoreve duke qene se aksi kalon ne nje largesi te konsiderueshme nga zonat e banuara.



Planimetria:

Aksi i propozuar ka nje gjatesi $L=12.85$ km, kalon ne afersi te fshtrave Helmes, Pepellash, Roshanj, Boshanj, Qafezez, Mollas, Qinam, Vodice, Skorovot, Bejkove, Selenice, Starie dhe Psar per te cilat jane parashikuar dalje ne menyre qe te kene akses ne aksin e rruges se qe do te ndertohet si me poshte:

- Ne prog 04+450m me fshatin Qafzez
- Ne prog 04+500m me fshatrat Helmes dhe Mollas
- Ne prog 05+275m me fshatrat Qafzez dhe Helmes
- Ne prog 06+350 m me fshatin Qafzez
- Ne prog 06+375m me fshatin Mollas
- Ne prog 07+775 m me fshatrat Qafzez dhe Mollas
- Ne prog 09+000 m me fshatrat Vodice, Qinam dhe Skorovot
- Ne prog 10+800 m me fshatin Vodice
- Ne prog 10+825m me fshatin Qinam
- Ne prog 13+543.69m me fshatrat Vodice, Bejkove, Selenice dhe Starje
- Ne prog 14+385.31m me fshatrat Vodice dhe Starje
- Ne prog 14+525m me fshatrat Bejkove dhe Starje
- Ne prog 15+025m me fshatrat Bejkove dhe Starje
- Ne prog 16+450m me fshatin Psar

Aksi i rruges nderpritet nga Lumi i Konopishtes ne Prog 4+100 ÷ 4+175 per te cilin kemi parashikuar ndertimin e nje ure ne forme Box $6 \times (10 \times 5)$ me gjatesi $L=23.5$ m dhe nga Lumi i Vodices ne Prog 11+775 ÷ 11+875 per te cilin kemi parashikuar ndertimin e nje Ure 4×29 m me $L=116$ m. Ne planimetri Aksi i rruges ka 20 rreze me $R=300-5000$ m qe i bie afersisht 1.5 kthesa/km. Aksi i rruges orientohet nga perendimi duke qene nen ndricimin diellor, gje qe do ndikojte pozitivisht ne shkrijen e debores dhe largimit te ujerave nga trupi i rruges.

Seksioni tip i aplikuar ne Rruge ndërrurbane me keto parametra:

- Kurora e rruges nga Progresivi PK 167 (Km 4+150) ÷ PK 681(Km 17+000.00)
- a. 2×3.25 m (korsi kalimi) + 2×1 (bankine).
 - b. Gjeresia e asfaltuar e kurores se rruges 6.5 m.
 - c. Gjeresia e kurores se rruges 8.5 m.


Paketa e shtresave rrugore :

